

# VETËVENDOSJE!

KOPJIMI LEJOHET.  
TË LUTEM KOPJOJE!

GAZETË JAVORE | 27 shtator 2005 | nr. 7 | www.vetevendosje.org

## Institucionalizimi kolonialist i shtypjes

Administratoret e UNMIK-ut dhe politikanët e Kosovës evitojnë bisedat për afatet sikurse që Viktorianët evitonin bisedat për seksin. Të parët qenien e tyre këtu e kanë të përkohshme por pa afat, të dytët i kanë të përhershme premtimet, të cilave që moti u ka skaduar afati. Të parët janë arroganca imperiale, të dytët janë përsëritja që bëhet zhurmë. Ngjashmëria me situatat koloniale veçsa fillon këtu. Ajo zgjatet për t'u totalizuar, thellohet për t'u bërë absolute. Objektiviteti i vrazhdë dhe drastik i pabarazisë e trand edhe atë limoninë agnostike. Nuk ka barazi sipas meritës, as barazi në bazë të nevojave, e as shansa të barabarta. Raporti i të ardhurave në mes të nëpunësve të administratës kolonialiste dhe vendase është përherë numër dyshifrorë. Sa merr pjesëtari i TMK-së apo i SHPK-së për një muaj, aq marrin polici ndërkombëtar dhe ushtari i KFOR-it vetëm për një ditë! Privilegjet strukturohen. Vlera e aftësisë ka për referencë preferencën e regjimit. Vendasit që e dinë gjuhën zyrtare të administratës kolonialiste të UNMIK-ut janë të privilegjuar. Ata çdoherë e çdokund kanë përparësi, sikurse sudanezi që dinte anglisht, marokani frëngjisht, kamerunasi gjermanisht apo mozambikasi portugalisht. Mirëpo, ata megjithatë mbesin vendas, mbesin jondërkombëtarë, dhe, në fund të fundit, shikohen si mostra të rastësishme të fiseve partikulare të gjetura në terra nullius, e që dallohen etnikisht ndërmjet vete. Qendra e vendosjes së administratave kolonialiste, sipas rregullit, gjithmonë ndodhet jashtë vendit që e qeverisin ato. Administrata kolonialiste angleze në Indi e kishte qendrën në Londër, ajo franceze në Algjeri e kishte në Paris, ajo italiane në Etiopi e kishte në Romë, ajo belge në Kongo e kishte në Bruksel etj. Edhe UNMIK-u e ka qendrën jashtë Kosovës: në Nju-Jork, ose edhe Bruksel e gjelju, por realisht shumë pak në Prishtinë. Misioni është i ngurtë. Liria brenda tij ka të bëjë me mënyrën, jo me synimet. Brenda kësaj mënyre hyn bashkëpunimi me vendasit, sepse hyjnë vendasit që nevojiten të bashkëpunojnë, për t'u sunduar populli dhe territori që ai popullon. Për këtë arsye, një grusht njerëzish që kontrollohen nga UNMIK-u, në emër të përfaqësimit, janë shpallur legjitim dhe kredibel. Ata na përfaqësojnë pikërisht sepse nuk na përfaqësojnë; pikërisht për shkak se nuk janë sikur ne, por u ngajnë administratorëve të lartë të UNMIK-ut: me xhipa dhe truproja, me sekretarësh dhe eskortë, me rroba të shtrenjta dhe syze dielli, me manire të duhura prej njerëzve që dërdëllisin kotësira. Ata shërbejnë të parët nëpër restorante: parkojnë kudo veturat e tyre të blinduara; nuk ndalen në semaforin e kuq; kudo terrorizojnë qytetarët me boritë shurdhuese që sinjalizojnë arritjen e tyre. Ata jo vetëm që janë pa masë të privilegjuar, por privilegji i tyre është normuar dhe legalizuar. Ata hiqen më të vlefshëm sesa të tjerët, sesa të zakonshmit. Të gjithë e kemi parë sesi deputetët e Kuvendit dhe ministrat e Qeverisë së Kosovës sillen si të tillë aty ku s'duhet: në sferën publike, para qytetarëve, para popullit. Dhe, të gjithë e kemi parë sjelljen e tyre prej pulave të lagura e të drojtura para zyrtarëve ndërkombëtarë nëpër institucionet e sistemit, pra mu atje ku do duhej të jenë deputetë e ministra, përfaqësues dhe mbrojtës të interesave të popullit. E gjithë kjo është e pandashme nga baza e institucioneve, e cila e përcakton funksionimin e tyre. Sovraniteti është normë strukturoese. Njësoj edhe mungesa e tij. E IPVQ-të nuk janë as sovra, përveçse jodemokratike. Ato korrupsionin e kanë dyfish të pashmangshëm: si nevojë të UNMIK-ut për ta ndërtuar shantazhin politik, dhe si pasojë të themeleve të mbrapshta dhe kërkesave edhe më të mbrapshta që i kanë para vetes. Hierarkia është masa e shkallës së korrupsionit brenda IPVQ-ve. Sa më lartë, aq më keq. Dhe, atje më së larti, kundërmor më së shumti. IPVQ-të problematizojnë me renditje të gabuar, meqenëse kësaj maskojnë mungesën e lirisë, mungesën e përputhjes së qenies së tyre me vullnetin e popullit. Jo vetëm kaq. IPVQ-të janë instrument i asimilimit politik të këtij vullneti dhe njëllj mesoligarkie. Ato e kryejnë punën

e ndyrë për UNMIK-un: filtojnë njerëzit për nga përshaltja e tyre me sistemin. Edhe një shkak më shumë, i cili ka bërë që tani pas gjashtë vjetëve të mbetet vetëm një lloj kundërshtimi që ka kuptim dhe efekt. Kundërshtimi kategorik, absolut dhe radikal. Për më tepër, po që se nuk e kundërshton aktivisht, përkundër që nuk pajtohet me sistemin, do ta mirëmbash atë pasivisht. Administratorët e UNMIK-ut dhe heqësit e institucioneve të sajura nga ai, nuk e përfaqësojnë popullin. Ata përfaqësojnë shtypjen e popullit. UNMIK-u është model i dominimit. Ai është i sofistikuar për hir të vetes së tij, jetegjatësisë së tij. Disa arrestohen nga policia e tij dhe dënohen nga gjykatat e tij, jo vetëm që të goditen forcat dhe lëvizjet përparimtare, por edhe që populli të besojë se vetë është i lirë dhe në këtë mënyrë ai të mos përpigjet të çlirohet. Pra, disa futen në burg, që të tjerët të mendojnë se nuk janë. Nderkaq, disa të tjerë mbikëqyren dhe konsiderohen problematik duke shmangur vëmendjen nga e vërteta: se sistemi është problemi. Në po të njëjtën anë, IPVQ-të janë infrastruktura e nënshtrimit, janë zgjidhje teknologjike e menaxhimit të UNMIK-ut. Ato kanë institucionalizuar kushtet e padrejta - rrethanën që është bërë vetë pamundësia. UNMIK-u të avanson nëse je rentabel për politikën e tij. IPVQ-të janë të tilla. IPVQ-të kanë për detyrë të na bindin se si ne nuk mundemi vetë, dhe të na i përkujtojnë të mirat e UNMIK-ut. Qëllimi sublim është që

zgjatjen e sundimit të tij. Ato 'të mira' aspirojnë amorfizimin e energjisë popullore që ngjizet nga pakënaqësia, ndërsa përtej institucioneve të politikës, ato kanë distribuim klasor: krijojnë dhe mirëmbajnë një shtresë njerëzish nga vendasit që qarkullojnë nëpër koktele dhe party, nëpër seminare e konferenca. Përderisa IPVQ-të janë tamponi institucional, kjo shtresë është tamponi shoqëror ndërmjet regjimit dhe pushtetit. Ata janë të punësuar nëpër zyra, kanë fundjavë të zgjatur, e cila fillon të premtën në mëngjes dhe mbaron të hënën në mbrëmje. Dubrovniku dhe Selaniku janë destinimet e preferuara. Këta pasurohen, duken më të shëndetshëm por edhe më bukur disi. Janë edhe përcaktues dhe tregues estetik. Me kohë, ata konsolidohen dhe homogjenizohen në një klasë shoqërore e cila i bashkëlidhet pushtetit. Ajo nuk identifikohet me brutalitetin e regjimit, por me efikasitetin dhe funksionalitetin e tij. Ata mentalisht e kompenzojnë pafuqinë e tyre, me vitalitetin e sistemit represiv. Spiunazhi tashmë nuk është sekret dhe as 'i ultë'. Ai kryhet nëpër restorane luksoze, ku për një darkë ekzotike në të cilën gjelërat i përngajnë veprave të Kandinsky-it, vendasit nga kjo shtresë u japin informata (ashtu si pa të keq) miqve tanë nga UNMIK-u. Përderisa respekti i popullit ndaj zyrtarëve dhe administratorëve të UNMIK-ut pothuajse është tretur fare, ai i kësaj shtrese është shndërruar në admirimin pervers që kanë të kolonizuarit për kolonizatorin. Realiteti politik për ta,



Foto: Rrezeart Galica - Gjiç

vetë populli t'i zgjedh njerëzit që do t'u pëlqejnë administratorëve ndërkombëtarë. Pra, të përfaqësoheni kundrejt UNMIK-ut me njerëz që, në fakt, do të përfaqësojnë UNMIK-un kundrejt neve. Për çdo ditë dëgjojmë politikanët e Kosovës duke thënë se standardet për Kosovën janë për të mirën tonë. Kjo s'do të thotë aspak se koncepti i standardeve nuk është imponuar, e as se është keqkuptuar. Kjo do të thotë se ai është internalizuar. Madje, gjithnjë e më shpesh, UNMIK-u nuk na përzihet, thonë ata. Njësoj, kjo s'është dëshmi e vetëqeverisjes, por e faktit se UNMIK-u as që ka nevojë të përzihet më. Edhe perceptimi i tyre disi përherë del i permbytur, sikurse ai para një pasqyre konkave: p.sh. politikanët e Kosovës thonë se si serbët e Kosovës duhet ta kuptojnë e pranojnë realitetin, ndërkohë që, në fakt, janë ata vetë që duhet ta bëjnë këtë. Ngase, në s'jemi shtet; Unioni i Serbisë dhe Malit të Zi është i tillë. Largimi i kësaj pasqyre për disa prej tyre do të thotë të pushojnë së gënjeri të tjerët, dhe për disa të tjerë të pushojnë së besuari gënjeshtër e vetes. Ama IPVQ-të gjithsesi janë brenda kësaj pasqyre, të kurthuara përjetësisht në të. Fundja, edhe të mirat që t'i bën sunduesi i padrejtë dhe arbitrar siç është UNMIK-u, kanë për qëllim

është ai i zyrave diplomatike, i politikanëve të huaj e hijerëndë, i demokracive dhe zhvillimit të pandalur në vendet e tyre, si dhe i ushtrive të tyre të fuqishme e krenare, që dëshmojnë në intervencimet 'humanitare' ose 'çlirimet' e popujve nga diktaturat. Të llogarisesh në ta, do të thotë të lejosh të jesh nën mëshirën e tyre. Mëshira e tyre është tërësisht e integruar në skizofreninë (e qëllimshme) të llojit Dr. Jekyll dhe Mr. Hyde. Drejtësia, barazia dhe liria nuk janë interes i yni rreth së cilit kalkulohet, por janë vlera fundamentale shoqërore, dhe si të tilla, të paçmueshme. Përpjekjet për të ushqehen nga vuajtjet prej mungesës së tyre. Nëse regjimi shtypës e posedon trupin tonë, fizikën dhe materialin, ai s'duhet asesi ta posedojë shpirtin e mendjen tonë. Ndryshimi i gjendjes drejt lirisë e mirëqenies fillon kur nis të refuzosh të përshatësh dhe të mashtrrohesh. Se mentaliteti brenda IPVQ-ve është disfatist, e dëshmojnë të vetëdijësuarit brenda tij. Edhe në rastin më të mirë, ata janë në gjendje të refuzojnë vetëm duke u tërhequr, por jo edhe duke u ballafaquar. E pikërisht ballafaqimi është fillimi i zgjidhjes, është rrua e lirisë kah realizimi i saj.

Albin Kurti

Çlirimtarët nuk ekzistojnë! Unë nuk jam çlirimtar! Popujt çlirojnë vetveten!  
Che Guevara

### Editorial

Gjithë pushteti legjislativ dhe ekzekutiv në lidhje me Kosovën, duke përfshirë administrimin e organeve të drejtësisë është në duart e UNMIK-ut dhe ushtrohet nga Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm. Për kryerjen e detyrave, që i janë besuar administratës së përkohshme me Rezolutën 1244 (1999) të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara, UNMIK-u ka nxjerrë akte ligjore në formë të rregulloresve. Pra, ligji i zbatueshëm në Kosovë janë rregulloret e UNMIK-ut, e, në bazë të rregullores së parë të UNMIK-ut edhe ligjet të cilat kanë qenë në fuqi në 'territorin' e Kosovës para datës 24 mars të vitit 1999, zbatohen në Kosovë, pra janë ligji i zbatueshëm. Me rregulloren 2001/9 për Kornizën Kushtetuese, UNMIK-u pat vendosur që të krijojë Institucionet e Përkohshme për Vetëqeverisje (Korniza Kushtetuese është "attachment" i rregullores 2001/9 dhe ajo mund të ndryshohet me rregulloret të UNMIK-ut). Këto institucione hartojnë ligje, por ato janë valide vetëm nëse nënshkruhen nga PSSP-ja, e PSSP-ja i nënshkruan ato ligje vetëm nëse nuk e shkelin Rezolutën 1244 të KS të OKB-së, por, me dije qoftë, edhe rregulloren 1999/1, që është rregullorja më e rëndësishme e UNMIK-ut. Ligjet që i nënshkruan PSSP-ja bëhen rregulloret të UNMIK-ut, e kjo do të thotë se IPVQ-të hartojnë rregulloret të UNMIK-ut. Institucionet e Kosovës miratojnë ligje që nuk janë në kundërshtim me ligjet që ka miratuar deri me 24 mars të vitit 1999 Parlamenti i Serbisë dhe Jugosllavisë sepse, përndryshe, do të shkellej Rezoluta 1244 dhe rregullorja 1999/1, dhe si rrjedhojë PSSP-ja nuk do t'i nënshkruante ato ligje. Kosova nuk qeveriset nga Korniza Kushtetuese, gjegjësisht nga rregullorja 2001/9, por nga Rezoluta 1244, sepse në bazë të Kornizës Kushtetuese, IPVQ-të kanë për obligim që të ushtrojnë 'pushtetin' e tyre në përputhje me Rezolutën 1244. PSSP-ja ka të drejtë të shpërndajë IPVQ-të, në rast se konsideron që ato veprojnë në kundërshtim me Rezolutën 1244... Për më tepër, përgjegjësitë e IPVQ-ve nën Kornizën Kushtetuese nuk ndikojnë ose nuk e zvogëlojnë autoritetin e PSSP-së në zbatimin e Rezolutës 1244. PSSP-ja e ka fjalën përfundimtare për gjithçka! Ndërsa, IPVQ-të janë dekor, apo siç thotë një mik imi: IPVQ-të janë dorë e zgjatur e UNMIK-ut!... Edhe përkundër faktit se ekzistojnë shumë kritere për definimin e një palë institucioneve si demokratike apo jodemokratike, konstatimi i Arend Lijphartit, sipas të cilit një palë institucioneve janë demokratike deri atëherë kur ato veprojnë "sipas parapëlqimeve të popullit", është kriteri më i rëndësishëm. E këtë kriter IPVQ-të s'e kanë plotësuar, pikërisht faktit se dy dokumentet themelore në bazë të të cilave qeveriset Kosova dhe funksionojnë këto institucione dhe UNMIK-u: Rezoluta 1244 - ky dokument e merr tërësisht parasysh Marrëveshjen e Rambujesë - dhe Korniza Kushtetuese, janë në kundërshtim frapant me vullnetin e qytetarëve të këtij vendi. IPVQ-të angazhohen për realizimin e "Standardeve para Statusit" (SPS), e realizimi i 'standardeve' çon në negociata me Serbinë, e negociatat çojnë në kompromis, e kompromisi do të thotë përjashtim e pavarësisë. Për më keq, njëri prej tetë standardeve është edhe sundimi i ligjit. Cilit ligj?! Ligjit që aplikohet në Kosovë! Por, cili ligj aplikohet në Kosovë?! Në Kosovë edhe ligji i Serbisë dhe Jugosllavisë është ligji i aplikueshëm. Edhe ligji i Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës (KSAK). Pra, rrjedhimisht, IPVQ-të, përveç tjerash, angazhohen që në Kosovë të zbatohet edhe ligji i miratuar nga Kuvendi i KSAK-së, Serbisë dhe Jugosllavisë.

Shkëlzen Gashi





Foto: Rrezeart Galica - Gji

# Mirazhi institucional

**Gëzim Krasniqi**

Të përdorësh dikë tjetër apo diçka tjetër në funksion të arritjes së një qëllimi të caktuar, jo rrallë tregohet të jetë mënyra e duhur e arritjes së suksesit. Kjo edhe është logjika e sundimit të administratës së UNMIK-ut në Kosovë. Rrjedhimisht, kjo është logjika e krijimit të IPVQ-ve. Të themeluara pas zgjedhjeve lokale të vitit 2000 dhe atyre qendrore një vit më vonë, IPVQ-të përfaqësojnë mekanizmin ndihmës të administratës ndërkombëtare në vendin tonë. Vetë procedura e inicimit të tyre dhe mbështetja ligjore e tyre (rregullorja 2001/9 e UNMIK-ut, ndryshe e quajtur Komizë Kushtetuese), tregojnë më së miri për natyrën dhe karakterin e IPVQ-ve. Dhe, më shumë se çdo gjë tjetër, ato janë produkt i mashtrimit përmes krijimit të iluzionit për ushtrim të demokracisë dhe vetëqeverisjes. Po cili është imazhi real i këtyre

institucioneve? Mjafton që të ndalemi para televizorit dhe të vështrijmë me kujdes paraqitjen e ndonjë deputeti, ministri apo vetë kryeparlamentarit, gjatë ndonjë prononcimi të tyre në hollin e parlamentit të Kosovës. Me këtë rast, është me rëndësi që më shumë sesa në paraqitjen e ndonjërit nga të sipërpërmendurit, shikimi jonë të hedhet tek prapavija, tek ajo që na kap syri në muret e hollit. Është fjala për muralet e 'famshme', të cilat në mënyrë simbolike na zbulojnë përpara, pa kurrfarë aluzioni e demagogjie, natyrën reale të IPVQ-ve. Institucione komizë, sikurse edhe komizat e zbratura të muraleve. Të tilla, që sikurse edhe vetë muralet e varura në mur, s'përbajnë asgjë reale nga ajo çfarë quhen - janë të zbrazëta. Realisht joefektive dhe joekzistente. Të etabluara në mendjen e njerëzve vetëm si emër, pa arritur të kenë domethënie. Pushteti i IPVQ-ve nuk mund të shihet, sepse ai nuk

ekziston. Ato janë vetëm një konstruksion i vetë UNMIK-ut, pushteti i pafund i të cilit e bën të pakuptimtë ekzistencën e tyre. Jetëgjatësia e administratës neokoloniale të UNMIK-ut në Kosovë, bëhet e mundur vetëm përmes ekzistimit të mekanizmave të saj përcjellës, përfshirë edhe IPVQ-të. Madje-madje, IPVQ-të sot janë shndërruar në njërin ndër arsyt kryesore të vazhdimit të ekzistimit të administrimit jodemokratik ndërkombëtar në vendin tonë. Ato janë të paafta politikisht, në masë të madhe të korruptuara, sepse në realitet ato u disenjuan nga administrata ndërkombëtare e UNMIK-ut për të qenë të tilla. U konstruktuan të tilla, në mënyrë që sot të shërbejnë si alibi për të gjitha dështimet e regjimit jodemokratik të UNMIK-ut në Kosovë. U konstruktuan për të qenë të padenja politikisht, të denja për neveri (kujtojeni skandalin e paradoditshëm në takimin

e Vjenës!). Me natyrën reale dhe gjendjen aktuale të tyre, IPVQ-të janë bërë 'arsyeshmëria' e vazhdimit të sundimit të UNMIK-ut në vendin tonë, kushti i domosdoshëm i ekzistimit të tij. Sepse IPVQ-të u konstruktuan të jenë të dështuara, të jenë mashtrim, në mënyrë që rezultatet që prodhon ky konstruksion pseudoinstitucional (rastet e korrupsionit, nepotizmit, mefshtësisë politike etj.) të forcojnë bindjen te njerëzit në Kosovë dhe te ndërkombëtarët, se UNMIK-u nuk e dashka pushtetin për vete; se ai e do pushtetin vetëm sepse njerëzit në Kosovë janë të dobët, qyqarë dhe të padenjë e të paafte për të qeverisur me veten. Ç'strategji e paskrupullt manipulimi! Sa për njerëzit e punësuar në IPVQ, ata përgjithësisht ndahen të paktën në dy kategori. Të parët, që s'janë të paktë në numër, fatkeqësisht, kanë iluzione se vërtet janë pjesë e institucioneve reale politike, dhe

se kjo është mënyra më e mirë për t'i shërbyer interesave të vendit tonë. Të tillët janë vetëm shpërfaqje e pasojave të mashtrimit dhe krijimit nga UNMIK-u të iluzionit për ekzistimin e demokracisë në Kosovë. Të tjerë kanë hyrë në IPVQ më së shumti për të realizuar interesat e tyre personale, dhe shumë prej tyre edhe mund të jenë të vetëdijshëm për karakterin real të këtyre institucioneve. Megjithatë, problemi kryesor qëndron mu te thelbi i arsyes së krijimit dhe mënyrës e disenjimit të IPVQ-ve, e në asnjë mënyrë të ndonjë zyrtar i korruptuar apo i paafte brenda tyre. Sepse emërtimi i tyre, pozitat e caktuara, simbolika e tyre, përpjekja për të paraqitur pushtetin real politik, veturat luksoze, truprojat dhe gjithçka tjetër reale tek to, përbëjnë mirazhin institucional në Kosovë. Komizat e zbratura të muraleve në hollin e Kuvendit të Kosovës, janë imazhi real i tyre!





# Tri simptomat

**Glauk Konjufca**

E kemi thënë edhe më parë: Institucionet e Përkohshme të Vetë-Qeverisjes ndaj UNMIK-ut qëndrojnë sikur simptoma 'mjekësore' në raport me sëmundjen. Simptoma është manifestimi i dukshëm i sëmundjes, e kjo e fundit shkaku real i saj. Simptoma kurrnjëherë nuk ka kuptim 'në vetvete', por vetëm ndaj sëmundjes. Ashtu siç kuptimi i IPVQ-ve banon në raportin e tyre vartës ndaj UNMIK-ut: ato janë themeluar prej kësaj administrate neokolonialiste për t'i shërbyer asaj, bazamenti juridik i tyre s'është tjetër veçse një rregullore e UNMIK-ut, kjo rregullore i referohet Rezolutës 1244, e cila mohon vullnetin e popullit...

Ky raport simptomatik 'mjekësor' i IPVQ-ve ndaj UNMIK-ut, prodhon simptomën e dytë - atë psikoanalitike. Njëjtë sikur që individi ndrydh një dëshirë të pakëndshme për unin, këto institucione politike janë të konstruara ta ndrydhin vullnetin e popullit. Por, struktura e simptomës psikoanalitike ka ligjësitë e veta kokëforta: dëshira e sapondrydhur nuk humbet; e kaluar në një pjesë tjetër të

shpirtit, ajo vazhdon presionin e saj. Njëjtë sikur 'personaliteti dinamik', shoqëria është një sistem forcash ndërvepruese. Interesat e qytetarit ndrydhen, ato nuk përmbushen. Por, gjithsesi, krejt ky joefikasitet institucional nuk shpërbëhet sakaq si një fluskë sapuni. Pasoja e drejtpërdrejtë e kësaj mospërmbushjeje është fermentimi i pakënaqësisë kolektive, rritja e saj e vazhdueshme.

Çdo rritje e pandalshme e pakënaqësisë, domosdo do ta ketë pikën e saj të vlimit. Pikërisht ky është kuptimi i kryengritjes së 17 marsit: një oqean problemesh të pazgjidhura, gjithë ai anashkalim i interesave vitale të qytetarëve për vite me radhë, një mohim sistematik i dëshirës shekullore të një populli për liri, formuan potencialin e një shpërthimi, i cili gjithnjë do ta gjejë pikën e tij të shkarkimit. Akumulimi i mëtejshëm i ngarkesës mund të zhduket vetëm po u mënjanua shkaku i tyre real - koordinatat ekzistuese politike të institucioneve tona. Arbitër i këtyre koordinatave është UNMIK-u.

Raporti kushtëzues i simptomës 'mjekësore' ndaj asaj psikoanalitike prodhon simp-

tomën e tretë sintetike. Këtu do të na nevojitet një referim i domosdoshëm në teorinë e filosofisë politike të Slavoj Zhizhekut. Sipas tij - një përpunim i mëtejshëm i tezave, të cilat Eric Santneri i nxori nga teoria e Filosofisë së Historisë së Walter Benjamins - veprimet e ardhshme, që synojnë ndryshime të mëdha sociale, paguajnë tërësinë e përpjekjeve të dështuara të së shkuarës, pamundësinë e përmbushjeve tërësore të ndërmarrjeve revolucionare. Dështimet e së kaluarës nuk vetëkufizohen për nga ndikimi vetëm në kohën kur ndodhin: si një potencial i akumuluar pa ia nda, ato kushtëzojnë mundësitë e aksioneve tona të ardhshme. Asgjë nuk nis nga një fillim i pastër. Ex nihilo, nihil fit.

Ku qëndron, pra, rëndësia e pakompensueshme e domosdoshmërisë së veprimit të tanishëm? Sigurisht - në ndryshimin e koordinatave politike sistematike, në mënyrë që humnerimi i simptomës së parë ta merr me vete atë të dytën; në mënyrë që këto të dyja të mos prodhojnë atë të tretën - barrë shumëfish më e rëndë për brezat që vijnë.

## Projektrezoluta, strukturat paralele dhe Grupi i Kontaktit

**Shkëlzen Gashi**

1.

Projektrezoluta e tre senatorëve, Voinovich, Lugar dhe Biden, dorëzuar Komitetit për Marrëdhënie të Jashtme të Senatit të SHBA-së, përveçse e merr parasysh Rezolutën 1244 të Këshillit të Sigurimit të OKB-së, ajo edhe fton liderët e Kosovës, Serbisë e Malit të Zi dhe përfaqësuesit e OKB-së, të punojnë drejt një marrëveshjeje për të ardhmen e statusit të Kosovës, e kjo marrëveshje, sipas projektrezolutës duhet të marrë parasysh ankesat dhe të kënaqë brengat kyçe të popullit të Kosovës dhe të popullit të Serbisë e Malit të Zi. Projektrezoluta kërkon kompromis nga Kosova dhe Serbia e Mali i Zi, për të arritur një marrëveshje dhe të promovojë stabilitet në rajon. Këtë projektrezolutë e ka përkrahur Vuk Drashkoviç, Ministër i Jashtëm i SMZ-së, duke shfaqur shpresën e tij se ajo do të pranohet. Po ashtu edhe Sanda Rashkoviç-Iviç, Kryetare e Qendrës Koordinuese për Kosovë e Metohi, është shprehur e kënaqur me këtë projektrezolutë, si dhe ka shtuar se kjo projektrezolutë dëshmon se për SHBA-të është e qartë se ndërrimi i kufijve në Ballkan do të çonte në një destabilizim të fuqishëm.

2.

Funksionimi i gjykatave paralele në vend është duke penguar seriozisht në përmbushjen e standardit të dytë - sundimin e ligjit në Kosovë. Kështu është shprehur ministrja e Shërbimeve Publike, Melihate Tërmmkollli, gjatë një takimi pune për standardet, ndërsa i ka kërkuar Departamentit të Drejtësisë që udhëhiqet nga UNMIK-u, që urgjentisht të ndërmarrë të gjitha masat për shpërbërjen e të gjitha strukturave paralele në Kosovë, me qëllim të shtimit të efikasitetit të punës së gjykatave. Mirëpo, strukturat paralele në Kosovë janë legale, sepse në bazë të Marrëveshjes së Rambujesë - e cila është valide, sepse kësaj marrëveshjeje i referohet tërësisht në katër vende Rezoluta 1244 - përkatësisht kapitullit I, pikës 7, paragrafëve a,b,c,d dhe e, thuhet se nuk do të ketë ndërhyrje në të drejtën e qytetarëve, dhe të bashkësive nacionale në Kosovë, që t'i bëhet thirrje institucioneve përkatëse të Republikës së Serbisë për ndihmë në fusha të ndryshme, si për shembull, në përpilimin e plan-programeve dhe standardeve shkollore; participimin në programe të ndihmës sociale...

3.

Pas mbledhjes së Grupit të Kontaktit, në çdo medium kosovar është potencuar mbështetja që ky grup po i jep lëvizjes përtej status quo-së në Kosovë. Bile-bile, disa medime kanë shkruar aq larg, sa që në ballinë kanë vënë tituj bombastik si: "Lamtumirë 1244". Është e vërtetë se Grupi i Kontaktit për Kosovën ka kumtuar se e mbështet plotësisht punën e ambasadorit Eide dhe pret raportin e tij gjithëpërfshirës. Por, diçka që nuk po përmendet në mediat tona, e që është theksuar në takimin e Grupit të Kontaktit është se zgjidhja e statusit të Kosovës duhet të bëhet në harmoni me Rezolutën 1244. Pra, ajo që është thënë në takimin e fundit të Grupit të Kontaktit, është tërësisht e pafavorshme për ne dhe e favorshme për Serbinë, e këtë e ka vërejtur edhe Dushan Batakoviç, këshilltar i kryetarit të Serbisë për Kosovën, i cili në një deklaratë për B92 pas takimit të Grupit të Kontaktit, ndër të tjera tha: 'vlerësimi i Grupit të Kontaktit është realist dhe i pranueshëm'. Rrjedhimisht, procesi që do të ndodhë në të ardhmen ka gjasa që të jetë një realizim i vullnetit të bashkësisë ndërkombëtare, por jo edhe i vullnetit të popullit të Kosovës, ashtu siç pretendon Bajram Kosumi, sepse ka shpërputhje mes vullnetit të këtyre dy palëve, e këtë po e dëshmon, veç tjerash, edhe takimi i fundit i Grupit të Kontaktit.



# Banorët dhe Qytetarët

"Pa shtet s'mund të ketë qytetari;  
pa qytetari s'mund të ketë demokraci!"\*

**Bekim Baliqi**

Mbi demokracinë, si koncept dhe doktrinë politike, ekzistojnë përkufizime të shumta dhe të ndryshme, mirëpo për të gjitha këto është i përbashkët roli i patjetërsueshëm i qytetarëve. Sigurisht se demokracia dhe zhvillimi i mirëfilltë shoqëror nuk arrihet vetëm me fjalë romantike dhe me fjalime politike. Një parakusht qenësor për zhvillimin, apo thjesht funksionimin demokratik të një shteti (siç lë të kuptohet nga citati i mësipërm), është formimi i vetëdijes së ngritur qytetare si dhe përgjegjësia që ka çdo qytetar në shkallë të barabartë si anëtar i atij komuniteti, në shfrytëzimin dhe mbrojtjen e principeve demokratike. Si shembull i fundit dhe më konkret, mund të merret referendumi francez dhe holandez për kushtetutën e BE-së, që flet shumë qartë për dënimin që i bënë këta qytetarë institucioneve (burokratike) evropiane. Nëse asnjë shembull tjetër, së paku ky do të duhej të ishte leksion i mjaftueshëm - si për stafin e UNMIK-ut ashtu edhe për pretendentët tonë politikë - se si vendimet e rëndësishme politike duhet të vijnë nga qytetarët dhe të përputhen me interesat e tyre. Mirëpo, fatkeqësisht, si nga bashkësia ndërkombëtare (të cilët vetëdefinojnë si 'International's') ashtu edhe nga politikanët vendorë (që nga të parët me cinizmin latent kolonialist emërohen si 'Local's') kosovarët konsiderohen banorë, e në asnjë mënyrë si qytetarë të Kosovës. Kësisoj, roli i qytetarëve (pra i banorëve) kosovarë kufizohet, e me këtë perceptohet vetëm si përcjellës - spektator i rrjedhave shoqërore-politike, e në asnjë mënyrë si pjesëmarrës - legjitimues i këtyre proceseve. Dhe kjo çështje është pika thelbësore e çdo demokracie, që si rrjedhim ka dështimin e një nomenklature politike, në rastin tonë, të politikës UNMIKase të 'ndërkombëtarëve' dhe 'vendorëve'.



Po të shqyrtojmë këtë fenomen edhe nga një prizëm tjetër, del se në politikën dhe marrëdhëniet ndërkombëtare, kur flitet për popujt ose kombet, në rend të parë nënkuptohen nënshtetasit, respektivisht qytetarët. Gjithashtu, në dokumentet zyrtare të OKB-së dhe të BE-së, termi nationality (kombësi) paraqitet si sinonim për citizenship (qytetari), dhe ngërthen kështu në vete anëtarin e një subjekti të caktuar politik. Në përputhje me këtë logjikë, por edhe sipas së drejtës ndërkombëtare, kosovarëve u mungon përfaqësimi dhe ushtrimi politik, si në rrafshin ndërkombëtar, e në mënyrë paradoksale, edhe në atë të brendshëm. Edhe pse politikanët, por edhe disa kinseintelektualë tanë dhe të huaj do të na përgjigjeshin se kjo çështje lidhet me statusin e Kosovës, prapëseprapë nuk do të mund të na kënaqnin me këso lloj shpjegimesh sipërfaqësore. Sepse gjatë gjithë këtyre viteve statusi i qytetarit është lënë anash, duke u anashkaluar me qëllim nga diskursi politik dhe publik. Formimi i identitetit qyte-

tar në Kosovë, që në fakt do të duhej të ishte formues dhe bartës i shtetit, u bë pjesë e lojës së egër partiake dhe klanore. Kalohej dhe ende kalohet, sipas nevojës së trendit propagandistik, nga një debat dhe diskurs i hapur (mbi Rezolutën 1244, pastaj mbi standardet, tash mbi statusin etj.), në tjetrin, duke mos pasur në asnjërin nga këto

ndonjë ndikim serioz e aq më pak sukses, por më shumë një kalkulum parazgjedhor. Por oponentët politik e kanë atë hapësirë (mediale) që t'u japin 'argumenteve' të tyre karakterin ose formën e dëshiruar për përfitime vetjake dhe partiake. Ata, në fund të fundit, në frazën hegeliane, bien vetë pre e këtyre mashtrimeve. Por edhe

banori kosovar detyrohet të durojë këtë gjendje mizore. Ai, në fakt, ka të drejtë të shqetësohet për skandale të përditshme, për korrupsionin, për nepotizmin, për padrejtësitë që i bëhen në çdo hap dhe vend, por ankesa e tij nuk do të jetë konsekuente, sepse të drejtat e tij janë drejta të një banori e jo të qytetarit. Ngase puna e qytetarit (në dallim prej banorit) është që të mos krijoj audiencë dhe mundësi që mashtrime të tilla të bëhen në emër të tyre, apo të interesave të tyre. Andaj, demokracia në Kosovë do të jetë funksionale vetëm atëherë kur të gjithë NE të akceptohemi dhe të veprojmë si QYTETARË, me të gjitha të drejtat, liritë por edhe obligimet dhe detyrimet që kemi ndaj shoqërisë dhe vendit tonë.

\* Juan J. Linz/Alfred Stepan (Hrsg.): Problems of Democratic Transition and Consolidation. Southern Europe, South America and Post-Communist Europe, Baltimore, 1996 fq. 28 cituar në Wolfgang Merkel: Systemtransformation. Eine Einführung in die Theorie und Empirie der Transformationsforschung, Opladen, Leske+Budrich, 1999 fq.383



Lëvizja VETËVENDOSJE! është komunitet i njerëzve që refuzojnë të nënshtrohen. Ajo synon arritjen dhe realizimin e vetëvendosjes për popullin e Kosovës. Lëvizja VETËVENDOSJE! angazhohet edhe për ndryshime radikale shoqërore e politike që do të mundësonin respektimin e të drejtave të njeriut, të drejtave civile dhe drejtësisë sociale për të gjithë dhe secilin në Kosovë pa kurrfarë diskriminimi.

**VETËVENDOSJE!**

**KOPJIMI LEJOHET.  
TË LUTEM KOPJOJE!**

Rr. Perandori Justinian, p. n.  
Prishtinë, Kosovë

038 222 704  
vetevendosje@hotmail.com  
vetevendosje@yahoo.com  
vetevendosje@gmail.com  
www.vetevendosje.org